



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN Tryeza për Kapitullin 23 – Ecuria e negociatave dhe zbatimi i prioriteteve për Kapitullin 23 në kuadër të integrimit evropian

17 prill 2026

Tirana International Hotel

10:00 - 12:00

Ministria e Drejtësisë dhe Lëvizja Evropiane në Shqipëri kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në këtë Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kriterin Politik "Funksionimi i Institucioneve Demokratike" në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian.

Kjo tryezë do t'i kushtohet ecurisë së negociatave dhe përbushjes së prioriteteve për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, duke ofruar një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit, sfidave kryesore dhe hapave të mëtejshëm në kuadër të procesit të integrimit evropian. Gjatë takimit do të trajtohet **roli i institucioneve në garantimin e të drejtave procedurale dhe ofrimin e ndihmës juridike falas**, si dhe nismat në fushën e të drejtave të fëmijëve, përfshirë hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2027–2030. Gjithashtu, do të prezantohen masat për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe nxitjen e ndërmjetësimit, gjetjet e anketave përkatëse, si dhe progresi në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit në kuadër të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2026–2030, duke nxitur njëkohësisht dialogun dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Tryeza për Kapitullin 23 do të mbledhë përfaqësues institucionalë, aktorë të shoqërisë civile, akademikë dhe ekspertë të fushës, me qëllim diskutimin e çështjeve kryesore dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete, duke kontribuar në mënyrë cilësore në këtë fazë të rëndësishme të procesit të integrimit evropian.

Ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

Kjo tryezë për GP - Kapitulli 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

&

## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Tryeza për Kapitullin 23 – Progresi në plotësimin e piketave të ndërmjetme për Kapitullin 23

17 prill 2026

Tirana International Hotel

10:00 - 12:00

09:30 – 10:00

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE

10:00 - 10:30

**HAPJA E TAKIMIT - Gjendja aktuale e negociatave për Kapitullin 23**

- Progresi aktual në përmbushjen e piketave të ndërmjetme për Kapitullin 23
- Forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e përfshirjes së shoqërisë civile dhe institucioneve publike gjatë këtij procesi

Tedi Dobi, Zëvendës Ministër i Drejtësisë dhe Negociator për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

10:30 - 10:50

**Zhvillimet në kuadër të prioritetëve për Kapitullin 23**

- Roli i Ministrisë së Drejtësisë në garantimin e të drejtave procedurale dhe ndihmën juridike falas
- Të drejtat e fëmijëve – iniciimi i punës për një Strategji Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2027-2030 nën optikën e angazhimeve të procesit të integrimit evropian
- Efiçenca e sistemit të drejtësisë dhe masat për nxitjen e ndërmjetësimit
- Prezantimi i gjetjeve të anketës dhe përditësim mbi ecurinë e procesit për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit në kuadër të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2026–2030

Elona Bano, Drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Projekteve në Fushën e Drejtësisë, Integrimit dhe Negociatave

10:50 - 11:30

**DISKUTIM I HAPUR ME PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE DHE GRUPET E INTERESIT**

11:30 - 12:00

**MBYLLJA E AKTIVITETIT DHE KOKTEJL**

Kjo tryezë për GP - Kapitullin 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI).

